

P.nr.2140/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIŽREN, gjyqtarja e vetme gjykuese Vjollca Buzhala, me praktikantja Hata Çoçaj, në lëndën penale ndaj të pandehurve M. M. dhe V. G., për shkak të veprave penale, rrezikimi i trafikut publik, nga nen 378 paragrafi 6 lidhur me paragrin 1, të KP-së, duke vodusur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2501-7/2017 të datës 16.11.2017, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 15.12.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M. M., nga i ati J. dhe e ëma S., e lindur P., i lindur më në Prizren, me banim në fshatin V., Komuna e Prizrenit, i martuar, punëtorë fizik, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë, identifikuar në bazë te letërnjoftimit me nr. të lëshuar nga MPB në Prishtinë.

I pandehuri V. G., nga i ati E., e ëma Sh., i lindur më në Prizren, me vendbanim në fshatin A., Komuna e Prizrenit, i martuar, punëtorë ndërtimi, ka te kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë.

JANË FAJTOR

I pandehuri: M. M.

Se më datën 02.09.2017, rreth orës 16:15, në Prizren, në rrugën P. - Zh., përballe gurëthyesit "Badallaj 5", rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurin, duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve dhe rrethanave ne rrugë, deri sa ishte duke e drejtuar automjetin e markës "Daimle – Chrysler 220 CDI", me targa të regjistrimit , i akuzuari M. M. tenton ti shmanget goditjes duke manovruar me timon nga ana e majtë e drejtimit të lëvizjes, me ç rast ne anësoret e anës se djathtë e godet automjetin e markës "VW Candy Pickup", si pasojë e goditjes e humbe kontrollin ndaj automjetit dhe përfundon jashtë rrugës, ku pos dëmeve materiale, lëndime te lehta trupore merr i dëmtuar V. G.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga nen 378 paragrafi 6 lidhur me paragrin 1, të KP-së.

I pandehuri: Visar Gashi

II. Se me datë dhe kohë te njëjtë si ne dispozitiv nën I të kësaj Aktakuze ishe ndalur në anën e djathë jashtë rrugës, por për një moment merr veprim të pasigurt për

tu kyçur ne rrugën magjistrale, duke mos siguuar se nje veprim i tillë do ti pengonte pjesëmarrësit e tjerë ne komunikacioni, si dhe duke mos dhënë përparësi kalimi automjetit te markës " Diamel-Chryser 220 CDI", i cili tentonte ti shmanget goditjes direkët me ç 'rast me anësoren e goditjes e humbe kontrollin ndaj automjetit dhe përfundon jashtë rrugës.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 parografi 6 lidhur me paragrafin 1, të KP-së

Andaj gjykata në kuptim të nenit 495 të KPP-së, jep ketë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti Përgjithshëm, për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP/II.nr.2501-7/17 të datës 16.11.2017.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 4, 41, 43 par.1 pika 1.3, nenit 46, 73 dhe nenit 378, të KP-së, dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarve ia shqipton:

DENIMIN ME GJOBË

Ashtu që M. G. për dispozitivin nën një të aktakuzës, ia cakton shumën në lartësinë prej 200 € (dyqindë) euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

V. G. për dispozitivin nën dy të aktakuzës ia cakton shumën në lartësinë prej 200 € (dyqindë) euro, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimini me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, nga ana e të akuzuarve atëherë gjykata konform nenit 46 par.3 të KP-së, dënimin me gjobë per secilin veq e veq në lartësi me nga 200 € do tu zëvendësojë me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditësh, ashtu që për çdo 20 € nga dënimini me gjobë do tu llogaritët me 1 (një) ditë burgim.

Të akuzuarit obligohen qe në mënyr solidare në emër të ekspertizës së komunikacionit të paguaj shumën prej 40.88 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore, shumën prej 20 euro, dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veq e veq shumën me nga 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren , pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën me nr. PP/It.nr.2501-7/2017 të datës 16.11.2017, kundër të pandehurve M. M. dhe V. G. për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1, të KP-së, të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur sëancën e shqyrimit kryesor, me të cilin të akuzuarit do t'i shqiptojë dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Pas shqimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës dhe atë: lexohet mendimi dhe konstatimi i ekspertit te komunikacionit rrugor inxhi. B. M. , te datës 30/31.10.2017, ne ekspertizën mjeko - ligjor te Dr. F. D. , te datës 26.10.2016 , Stacionit Policor ne Prizren – Njesia e Trfikut regional, ka parashtruar kallzim penal me nr. 2017-GR-0698, deklarata e te pandehurve të datës 02.09.2017, Raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia", në Prizren, për të akuzuarin Merlin Memaj të protokollit 10348, të datës 02.09.2017, Raporti mjekësor i Spitalit Rajonal "Emergjencia", në Prizren, për të akuzuarin V. G. , si dhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës.

Kjo gjykatë konsideron nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, u vërtetua se i pandehuri e ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet edhe qëllimi i sanksionit penal, që në të ardhmen i akuzuari të mos kryej ndonjë veprë penale të paraparë me ligj

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 493 të KPP-së.


Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë, në kuptim të nenit 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2140/17, me datë 15.12.2017

Praktikantja:
Hata Çoçaj

Gjyqtarja:
Vjolica Buzhalaj



UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në gjykatën Themelore në Prizren. Po qese i pandehuri nuk parashtron kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formën e prerë.

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'GJ. N. KU' at the top, followed by '2A' and 'AFIC'. Below this, a large, sweeping line extends from the right towards the left. At the end of this line, the date '15. II. IX' is written vertically, with a large, stylized initial 'X' drawn below it.